



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.14, datë 27.07.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT NË INFRASTRUKTURË PËR OBJEKTIN:  
“NDËRHYRJE E INTEGRUAR PËR PËRMIRËSIMIN E AKSESIT, SHËRBIMEVE DHE  
RIKUALIFIKIM NË ZONËN E PLAZHIT, LIVADH – DHRALË, MOLI DRYMADESIT”,  
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Bashkinë Himarë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit në Infrastrukturë për objektin: “Ndërhyrje e Integruar për Përmirësimin e Aksesit, Shërbimeve dhe Rikualifikim në Zonën e Plazhit, Livadh – Dhralë, Moli Drymadesit”, me vendndodhje në Bashkinë Himarë, me subjekt zhvillues Bashkia Himarë
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

